



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 67, 68 dhe 69 paragrafi 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 5 paragrafi c të Ligjit numër 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, si dhe nenin 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

**KONKURS PËR PRANIM**

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

<b>Emri i grupit:</b>	Specialistë të Arsimit
<b>Institucioni:</b>	Komuna e Gjakovës
<b>Njësia:</b>	Drejtoria për Arsim
<b>Lloji i pozitave:</b>	Nëpunës i Shërbimit Publik
<b>Data e njoftimit:</b>	22.07.2022
<b>Afati për aplikim:</b>	22.08.2022 – 05.09.2022
<b>Numri i referencës:</b>	01-111/01-18873
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	E pacaktuar

**1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:**

- a. Të realizoj plan programin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e punës;
- b. Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- c. Të përgatit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- d. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me Udhëzimet Kurikulare;
- e. Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- f. Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës, si dhe
- g. Detyrat tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

**2. Kërkesat e përgjithshme për pranimit:**

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

### 3. Kërkesat e përgjithshme formale:

Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

### 4. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Statusi	Vendi i punës
1.	Një (1) mësimdhënës i lëndëve mjekësore teorike (Mjek i Përgjithshëm) me 8 orë mësimi në javë.  Një (1) mësimdhënës për modulet e praktikës profesionale MPP 10-sh me 6 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHMLM “Hysni Zajmi”
2.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjeografisë me 7 orë mësimi në javë.  Një (1) mësimdhënës për lëndën e historisë me 8 orë mësimi në javë.  Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “8 Dëshmorët”
3.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 8 orë mësimi në javë.  Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Kongresi i Manastirit”
4.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Luigj Gurakuqi”
5.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Pjetër Bogdani”
6.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Engjëll Gjoni”
7.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Bajram Sadriu”
8.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Zenel Sadiku”
9.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e edukatës fizike me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Dëshmorët e Kombit”
10.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Sylejman Vokshi”
11.	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Ganimete Terbeshi”
12.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Hamëz Cena”
13.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 5 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Jahë Salihu”

14.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 4 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Dy Dëshmorët”
15.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjeografisë me 7 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Dëshmorët e Hereçit”
16.	Një (1) mësimdhënës të baletit me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	Shkolla e Muzikës “Prek Jakova”
17.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e hotelerisë me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHMLE “Kadri Kusari”

## 5. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimi* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga “UÇK” numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

## 6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Rezymeja personale (CV);
- c. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- d. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të noterizuara (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- e. Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- f. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- g. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*);

## 7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim
- b. Intervistë

## 8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

## 9. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.